



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
*Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborna komisija za žalbe i molbe*

**A nr. 204/2010**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Sali Toplica, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Srdjan Mirkoviq nga Iniciativa Qytetare “Zavicaj” nga fshati Pasjan -Partesh, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16 Korrik 2010 mori këtë:

### V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### A R S Y E T I M I

Z. Srdjan Mirkoviq nga Iniciativa Qytetare “Zavicaj” nga fshati Pasjan-Partesh, ka parashtruar ankesë më datë 22.06.2010, me të cilën pretendon se z. Bogoljub Staletoviq, Zëvendës kryeshefi i KQZ-së më datë 20.06.2010, në VV nr. 3602/01R pas orës 13:15 ka urdhëruar që të gjithë anëtarët e KVV-ve të jenë të pranishme gjatë votimit nga ana e votuesve të cilët votojnë me ndihmës (përcjellës).

Sipas parashtruesit të ankesës anëtari i KVV-së çdo herë është përcaktuar nga radhët e Iniciativës Qytetare “GIZZO”, të cilët kanë ndikuar dhe manipuluar tek votuesit.

### F A K T E T

Më 13 korrik 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Z. Srdjan Mirkoviq nga Iniciativa Qytetare “Zavicaj” nga fshati Pasjan-Partesh, parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur manipulime dhe ndikime tek votuesit nga ana e KVV-ve, të cilët janë urdhëruar nga Zëvendës Kryeshefi i KQZ-së, Z. Bogoljub Staletoviq.

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi si provë lidhur me manipulimin e votuesve nga ana e KVV-ve.

### A N A L I Z Ë

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme*

në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr 03/L- 073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

*3.6 (b) Një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkëljes së pretenduar*

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e nenit 3.6 pika (b) dhe pika (c), të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

A nr. 204/2010 më datën 16 Korrik 2010

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala

